



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Pristine datë, 09.01.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **04.01.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **ITKOMED SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE"** me Nr. të Prok: **206-23-14103-1-1-1** nxjerr:

V E N D I M

1. **PRANOHET**, si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **ITKOMED SH.P.K.** e dt. 04.01.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE"** me Nr. të Prok: **206-23-14103-1-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 20.12.2023.
2. Plotësohet/ndryshohet për Lot 4, Njoftimi për Kontratë i datës 20.12.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **ITKOMED SH.P.K.** me date 04.01.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE"** me Nr. të Prok: **206-23-14103-1-1-1**. AK-MSh, me datë 09.01.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Nuk është specifikuar ndonjë dispozite e shkelur nga AK-MSh.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Persa i perket Dosjes së Tenderit me titull **Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE**, me nr të Prokurimit: **206-23-14103-1-1-1**, kerkojme rishqyrtimin e dosjes.

Gauze with Hyaluronic acid 2mg Sulphadiazine 40mg eshte klasifikuar nga AKPPM si produkt medicinal pershkak te permbajtjes se substances aktive dhe jo si pajisje mjekesore sic eshte paraqitur ne Dosje te tenderit.

Ky produkt permban edhe certifikaten e Marketing Autorizimit (e gjeni te bashkengjitur).

Para disa viteve ne Tenderin e shpallur athere nga MSH, ka qene i njejti keqkuptim. Si pasoje, ne e kemi derguar lenden ne OSHP dhe vendimi i OSHP ka qene se ne kemi te drejte, pra produkti ne fjale eshte Produkt medicinal dhe kerkon me patjeter Marketing Autorizimin dhe nuk eshte Pajisje mjekesore (Vendimin e OSHP e gjeni te bashkengjitur).

Muajin e kaluar ne tenderin e shpallur nga SHSKUK, perseri produkti eshte shpallur si Pajisje mjekesore, por pasi ne kemi derguar te gjitha deshmite qe e vertetojne te kunderten, eshte pranuar dhe korigjuar Dosja (e gjeni ne emailin te cilin ua kam nisur me date 03.01.2024 vendimin e leshuar nga SHSKUK zyra e Prokurimit).

Andaj ju lutemi shume qe ta merrni perbaze ankesen tone dhe si pasoje e deshmive te ofruara ta korigjoni dosjen, ne te kunderten pa deshiren tone, do na duhet qe perseri te i drejtohem Organit Shqyrtues te Prokurimit (OSHP).

Duke shpresuar per mirekuptimin tuaj,

Dëmet materiale

Disa nga demet materile jane:

Shpenzimet e importit

Demtimi i imazhit

Fitimi i munguar duke u nisur nga planifikimi i tenderit (porosi e realizuar ne fabrike)

Konkurence e pa barabarte sepse me kete variant konkurojne produktet qe nuk kane certifikate te AM, duke rezultuar me produkte te pa kontrolluara nga AKPPM.

Përgjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Pretendimin e juaj ankimor e konsiderojme te bazuar. Përfshirja e këtij produkti si material shpenzues është bere bazuar ne kategorizimin sipas LBE, por duke marre parasysh përbërjen e produktit dhe faktin se është i regjistruar me AM ne AKPPM, edhe MSh njëjtë si SHSKUK do ta bëjmë korigjimin për Lot 4 dhe ne kuadër te kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, do te kërkohet Autorizimi për Marketing.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit